

# Refugee agencies help and advice



June 2008

Albanian

## A keni aplikuar për azil para datës 5 mars 2007 dhe nuk ju është dhënë e drejta për të qëndruar në Britaninë e Madhe?

Nëse përgjigja është 'po', atëherë ka mundësi që aplikimi juaj po merret në shqyrtim nga Direktorati Vendim-marrës për Çështjet (Case Resolution Directorate), i cili është pjesë e Agjencisë së Britanike të Kufijve (UK Border Agency - UKBA) pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme. Direktorati merret me aplikimet e vjetra për azil për të cilat nuk është marrë ende një vendim. Duke filluar që tani deri në vitin 2011, ata do të shqyrtojnë pjesën më të madhe të atyre çështjeve që janë dorëzuar para muajt Mars 2007.

Direktorati i dërgon letër disa azil kërkuesve për t'i bërë të ditur se çështja e tyre është përzgjedhur për shqyrtim.

### Ç'duhet të bëni kur merrni një letër nga Agjencia Britanike e Kufinjve (UKBA)?

Letra e dërguar nga UKBA në të shumtën e rasteve përmban si mëposhtë:

- një shpjegim që çështja juaj është përzgjedhur për shqyrtim
- detajet e kontaktit të personit që merret me çështjen tuaj
- informacion se si mund të merrni këshillim ligjor
- informacion se si njerëzit mund të kthehen në vendin e tyre me vullnet të lirë.

Gjithashtu, UKBA duhet t'i dërgoj një kopje të letrës suaj përfaqësuesit tuaj ligjor (nëse keni një të tillë).

UKBA mund të përfshijë gjithashtu tek letra informacionin e detajuar të çështjes tuaj, dhe t'ju kërkoj që të kontrolloni nëse ky informacion është ende i saktë. Në letër mund t'ju kërkohet që të jepni më shumë informacion, gjë të cilën ju ose përfaqësuesi juaj ligjor duhet t'ja dërgoni personit në UKBA që merret me çështjen tuaj brenda **21 ditësh**. Është e rëndësishme që ju ose përfaqësuesi juaj ligjor të siguroheni se letra me përgjigjen tuaj arrin brenda 21 ditësh që nga momenti kur keni marrë letrën nga UKBA.

Kur merrni një letër më e mira është që të kërkonit më tepër këshillim dhe asistencë – shihni faqen tjetër. Edhe nëse nuk arrini të merrni këshillim ligjor në kohë, gjithësesi ju duhet t'i përgjigjeni letrës brenda kohës së caktuar, por duhet të shkruani aty që ju do të kërkonit këshillim ligjor lidhur me çështjen tuaj. Gjithmonë mbani një kopje të letrave që i dërgoni tek UKBA dhe mbani shënim të gjitha telefonatat që bëni tek kjo agjenci.

Fletëpalosje të tjera janë të disponueshme tek <http://languages.refugeecouncil.org.uk>

Asylum Support Partnership is a partnership project hosted by the British Refugee Council  
British Refugee Council, (commonly called the Refugee Council) is a company limited by guarantee registered in England and Wales, [No 2727514] and a registered charity, [No 1014576].  
Registered office: 240-250 Ferndale Road, London SW9 8BB, United Kingdom



## Si mund të kontaktoni UKBA nëse nuk dini emrin e personit që merret me çështjen tuaj?

Nëse nuk keni marrë letër nga UKBA, por dëshironi t'i bëni të ditur asaj se rrethanat tuaja kanë ndryshuar (për shembull, jeni bërë me fëmijë, jeni martuar ose keni ndryshuar adresë), atëherë ju duhet të kontaktoni Zyren për Informacion rreth Emigracionit (Immigration Enquiry Bureau - IEB) në telefonin 0870 606 7766.

IEB do t'ju kërkoj numrin tuaj të protokollit, emrin, kombësinë, datën e lindjes dhe datën kur ju aplikuat për azil. Më pas, IEB do ju pajisi me një adresë ku mund t'i shkruani personit që merret me çështjen tuaj, në mënyrë që ta informoni për të rejtat e tua lidhur me ndryshimet në rrethanat që ndodheni. IEB nuk do të mundet t'ju thotë se kur do të merret një vendim për çështjen tuaj. Nëse adresa juaj ka ndryshuar, atëherë ju mund t'i jepni adresën e re IEB nëpërmjet telefonit.

## A mund të bëj që UKBA të shqyrtojë çështjen time tani?

Ju duhet ta diskutoni me përfaqësuesin tuaj ligjor, nëse mendoni se ka arsye të veçanta për të cilat çështja juaj duhet të merret parasysh tani, UKBA ka rënë dakort të marrë parasysh përfaqësimet me shkrim të kryera nga një përfaqësues ligjor ose nga Deputeti (MP) juaj i zonës.

## A i shkruan UKBA të gjithë azil kërkuesve?

Jo. UKBA nuk i shkruan letër disa azil kërkuesish, me çështjet e të cilëve po merret. Për shembull, nëse dikush ka kryer një krim, nuk i është përmbajtur rregullave të UKBA ose ka punuar ilegalisht, ka shumë pak shanse që ky person të marrë letër para se Agjencia Britanike e Kufinjve tashmë ka ndërmarrë hapa për t'a larguar atë. Nëse jeni i shqetësuar për situatën tuaj është e rëndësishme që të kerkoni këshillim ligjor – shihni si më poshtë.

Nëse jeni i sigurtë në vetvete, që nuk bëni pjesë në asnjë nga grupet e përmendura më sipër dhe se UKBA duhet të rinovojë informacionin lidhur me çështjen tuaj, atëherë më e mira është të presësh për ardhjen e letrës. Megjithatë, ju duhet të siguroheni që do keni mundësi të merrni këshillim ligjor sa më shpejt, duke qenë se koha për t'i kthyer përgjigje letrës së dërguar nga UKBA (21 ditë) nuk është e gjatë.

Nëse mendoni se keni disa gjëra për ti thënë UKBA lidhur me çështjen tuaj është e rëndësishme që më parë të merrni këshillim ligjor.

## Marrja e Këshillimit

Ju duhet të:

- kontaktoni përfaqësuesin ligjor që është marrë me çështjen tuaj më parë ose,
- gjeni një përfaqësues ligjor i cili mund t'ju ndihmojë dhe të siguroheni që ai do t'ju ndihmojë kur të merrni letrën.

Ju mund të gjeni një përfaqësues ligjor duke kontaktuar **Këshillimin Ligjor Komunitar (Community Legal Advice)** në 0845 345 4345 dhe ata mund t'ju drejtojnë tek një përfaqësues ligjor ose organizatë që ndodhet në zonën tuaj, të cilët mund t'ju këshillojnë më tej. Ose ju mund të vizitoni faqen e internetit [www.communitylegaladvice.org.uk](http://www.communitylegaladvice.org.uk).

Përfaqësuesi juaj ligjor duhet të vijë nga një organizatë e cila ka kontakte me Komisionin e Shërbimeve Ligjore (Legal Services Commission) tek ligji për Emigracionin, ose është një këshillues i regjistruar në **Zyren e Komisionerit të Shërbimeve për Emigracionin (Office of the Immigration Services Commissioner - OISC)**. Ju mund të kontaktoni OISC dhe të kerkoni listë e organizata që janë aprovuar, të cilat japin këshillim lidhur me ligjin për azil. Telefononi: 0845 000 0046 ose vizitoni faqen e internetit [www.oisc.gov.uk](http://www.oisc.gov.uk)

Ju nuk keni pse të pagoni për keshillim ligjor, sepse përfaqësuesi juaj ligjor mund të aplikojë për asistencë financiare ligjore. Këshillues të agjencive për refugjatët mund t'ju ndihmojnë që të gjeni një të tillë.

Kur të takoheni me përfaqësuesin tuaj ligjor ju duhet të:

- Siguroheni që dispononi të gjithë dokumentat e rëndësishme, për shembull një kopje të deklaratës origjinale për azil, të gjitha letrat refuzuese, vendimet nga Gjykata për Azil dhe Emigracion dhe çdo korrespondencë që nga ajo kohë.
- Është mirë të bëni një kopje të të gjithë këtyre dokumentave dhe t'i mbani në një vend, ku mund t'i merrni me vonë përsëri. Nëse jeni ndalur dhe mbaheni nga UKBA do të keni nevojë për një mik i cili të marrë dokumentat për ju, sa më shpejtë.

## Keni aplikuar për azil para muajt Prill të 2003?

Nëse keni aplikuar për azil para muajt Prill të 2003, kërkesa juaj është refuzuar, por mund t'ju jetë dhënë e drejta e statusit të refugjatit ose një leje e jashtëzakonshme për të qëndruar nëse Ministria e Punëve të Brendshme ka marrë vendimin më shpejt, atëherë ju lutem lexoni udhëzimet tek faqja e internetit të Këshilli për Refugjatët (Refugee Council):  
[www.refugeecouncil.org.uk/policy/briefings/2007/delays.htm](http://www.refugeecouncil.org.uk/policy/briefings/2007/delays.htm)

Nëse keni pyetje lidhur me informacionin e dhënë në këtë fletëpalosje ju lutem kontaktoni me një nga agjencitë për refugjatët të listuara si më poshtë:

### **Zyrat Qëndrore të Linjës Telefonike Ndihmëse për Emigrantët (Migrant Helpline) (Kent, Sussex)**

Tel: 01304 203 977

[www.migranthelpline.org.uk](http://www.migranthelpline.org.uk)

### **Qendra e Burimeve Multi-Kulturore (Multi-Cultural Resource Centre) (Northern Ireland)**

Tel: 02890 238 645

[www.mcrc-ni.org](http://www.mcrc-ni.org)

### **Zyrat Qëndrore të Shërbimve për Refugjatët të Anglisë së Veriut (North of England Refugee Service) (North East)**

Tel: 0191 245 7311

[www.refugee.org.uk](http://www.refugee.org.uk)

### **Zyrat Qëndrore të Aksionit Refugjat (Refugee Action) (East Midlands, North West, South Central, South West)**

Tel: 020 7654 7700

[www.refugee-action.org.uk](http://www.refugee-action.org.uk)

### **Zyrat Qëndrore të Këshillit për Refugjatët (Refugee Council) (London, East of England, Yorkshire & Humberside, West Midlands)**

Tel: 020 7346 6700

[www.refugeecouncil.org.uk](http://www.refugeecouncil.org.uk)

<http://languages.refugeecouncil.org.uk>

**Zyrat Qendore të Këshillit për Refugjatët në Skoci (Scottish Refugee Council) (Scotland)**

Tel: 0141 248 9799

Telefon pa pagesë (Freephone): 0800 085 6087

[www.scottishrefugeecouncil.org.uk](http://www.scottishrefugeecouncil.org.uk)

**Zyrat Qëndrore të Këshillit për Refugjatët në Uells (Welsh Refugee Council) (Wales)**

Tel: 029 2048 9800

[www.welshrefugeecouncil.org](http://www.welshrefugeecouncil.org)

Asylum Support Partnership consists of:

Migrant Helpline, charity number: 1088631 [www.migranthelpline.org](http://www.migranthelpline.org)

Refugee Action, charity number: 283660 [www.refugee-action.org.uk](http://www.refugee-action.org.uk)

Refugee Council, charity number: 1014 576 [www.refugeecouncil.org.uk](http://www.refugeecouncil.org.uk)

Scottish Refugee Council, charity number: SC008639 [www.scottishrefugeecouncil.org.uk](http://www.scottishrefugeecouncil.org.uk)

Welsh Refugee Council, charity number: 1044885 [www.welshrefugeecouncil.org.uk](http://www.welshrefugeecouncil.org.uk)